



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primijseno/Prodato Received/Delivery	26-05	2021	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednitsa Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Dilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKENSHIK	2650	2021	1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.280/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.280/2021, të datës 15.04.2021, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr. "Skënderbeu" Lipjan, kundër Vendimit KA.nr.13/2021 të datës 26.02.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen administrative-juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 26.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.280/2021 e datës 15.04.2021, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.13/2021 i datës 26.02.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja Zyrtare Ligjore në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, më datë 15.04.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1805/2021 të regjistruar me numër A.nr.280/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.13/2021 të datës 26.02.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullos Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.04.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë

28.04.2021 ka pranuar përgjigjen në kërkesë me numër protokolli 2042/2021 së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas konstatimit se ankesa është e pranueshme, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.280/2021 të datës 15.04.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.04.2021; Vendimin KA.nr.13/2021 të datës 26.02.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesë e datës 22.01.2020; Kërkesë për ndihmë me rastin e vdekjes së anëtarit e datës 21.01.2020; Kërkesë për ndihmë me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes e datës 22.01.2020; Certifikatë e vdekjes me numër V10375264 e datës 14.01.2021; Certifikatë e lindjes me numër L23695843 e datës 15.01.2020; Vendim i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës DS-27/2021 i datës 18.01.2021; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 2042 e datës 28.04.2021; Ankesë drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës e datës 16.02.2021; E-mail nga M.H. për H.R. i datës 20.01.2021; Vendim për dhënien e ndihmës me rastin e vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së nëpunësit civil i datës 08.06.2015; Përsëritje e Kërkesës për ndihmë me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes e datës 08.01.2021; E-mail nga H.T. për B.G. i datës 20.05.2021; Deklaratë për Bashkësinë Familjare i datës 12.05.2021; E-mail nga F.K. për C.Z. i datës 24.05.2021; E-mail nga C.Z. për F.K. i datës 24.05.2021; Pliko me numër R1537353 e datës 08.04.2021; E-mail nga F.K. për C.Z. i datës 24.05.2021; E-mail nga F.K. për C.Z. i datës 24.05.2021; E-mail nga C.Z. për F.K. i datës 24.05.2021; Akt Emërim i datës 24.07.2017; E-mail nga për C.Z. i datës 25.05.2021; Pliko me numër R1483256 i datës 05.03.2021; Data e Pranimit 09.03.2021; E-mail nga H.T. për C.Z. i datës 25.05.2021;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses si dhe pas analizimit të shkresave të lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, ka konstatuar se ankesa e ankueses:

është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, gje gjësisht sipas Akt Emërimit me Nr.Ref: 106/17 të datës 24.07.2017, konstatohet se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës Zyrtare Ligjore në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan.

Ankuesja me datë 21.01.2020 i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Themelore dega në Lipjan, për ndihmë me rastin e vdekjes së motrës së saj J.S, e cila kërkesa nga Administratori i kësaj gjykate është përcjell për shqyrtim në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (me tej SKGJ).

Lidhur me kërkesën e ankueses, Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së me Vendimin me numër DS-27/2021 të datës 18.01.2021, ka refuzuar kërkesën e ankueses për ndihmë në rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.

Kundër Vendimit DS-27/2021 të datës 18.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së, ankuesja me datë 16.02.2021 ka ushtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ku i njëjti me Vendimin me numër KA.nr.13/2021 të datës 26.02.2021, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KA.nr.13/2021 i datës 26.02.2021, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, për shkak të shkeljes së dispozitave

procedurale dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, duke pretenduar se vendimi i kundërshtuar me ankesë si dhe Vendimi DS-27/2021 i datës 18.01.2021 të Drejtorit i Përgjithshëm të SKGJK-së, janë në kundërshtim me nenin 22 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe Ligjin, Ligjin për Familjen si dhe Ligjin për Trashëgimin. Me tej propozon që Këshilli ta ndryshoj Vendimin e shkallës së parë dhe ti njoh ankueses të drejtën e kompensimit me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave lidhur me pretendimin ankimor të ankueses ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *2. Nëpunësit civil, kanë të drejtat në vijim; 2.4 ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësit civil;* si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22 paragrafi 2, ku përcaktohet se: *2. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil, në rast të vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, nëpunësi civil gëzon të drejtën e ndihmës institucionale, përmes kompensimit të një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.*

Ndërsa lidhur me faktin se kush përbënë familjen, Kolegji për shqyrtimin e ankesave i është referuar dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës lidhur me përkufizimin e bashkësisë familjare, ku në nenin 271 përcaktohet se: *Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji. Çështja e përkufizimit të familjes sipas dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, është konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit të Kosovës, në Aktgjykimin A.A.nr.14/2017.*

Andaj, bazuar në shkresat e lëndës respektivisht certifikatat e gjendjes civile, Kolegji ka konstatuar se e ndjera *ka qenë motër e ankueses, ndërsa ankuesja ka statusin beqare dhe pasi që në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se ankuesja ka qenë duke jetuar në bashkësi familjare me të ndjerën apo ka ndarë ekonomi të përbashkët me të, Kolegji vlerëson së pretendimi ankimor i ankueses për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbim Civil, është i pa bazuar.*


Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.280/2021.

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

